



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



## **Përgjigje ndaj komenteve**

**Shqyrtimi i Dhjetë i Tarifave të Energjisë Elektrike**

**SHTE10 (2016-2017)**

**Viti Relevant 4 i Periudhës Rregullative**

### **DEKLARATË**

**Këto përgjigje ndaj komenteve janë përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesuara. Këto nuk paraqesin vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si të tilla.**

**31 Mars 2016**



## Përmbajtja

<b>Pasqyrë e Kontrollit të Çmimit .....</b>	<b>6</b>
<b>1 Hyrje.....</b>	<b>8</b>
<b>2 Struktura e këtij raporti.....</b>	<b>8</b>
<b>3 Përgjigjet e ZRRE ndaj komenteve të KEK-ut .....</b>	<b>8</b>
3.1 Komentet e dhëna nga KEK-u .....	8
3.2 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KEK-ut .....	10
<b>4 Përgjigjet e ZRRE ndaj komenteve të KOSTT-it .....</b>	<b>11</b>
4.1 Komentet e dhëna nga KOSTT-i .....	11
4.2 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KOSTT-it .....	12
<b>5 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KEDS-it.....</b>	<b>12</b>
5.1 Komentet e dhëna nga KEDS-i .....	12
5.2 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KEDS.....	13
<b>6 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KESCO-s .....</b>	<b>14</b>
6.1 Komentet e dhëna nga KESCO .....	14
6.2 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KESCO.....	15
<b>7 Propozimet finale të ZRRE-së për MAR të SHTE10.....</b>	<b>16</b>
7.1 Propozimi i MAR të lejuar për KEK.....	16
7.2 Kosto e blerjes së energjisë me shumicë - WHPC.....	17
7.3 Propozimi i MAR të lejuar për KOSTT .....	18
Propozimi i MAR të lejuar për KEDS.....	19
7.4 Propozimi i MAR të lejuar për FPEE .....	20



## Abstrakt

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aktualisht është duke kryer Përshtatjen e Rregullt dhe procesin e Azhurnimit Vjetor për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) të Kompanive të Rregulluara në Sektorin e Energjisë Elektrike në kuadër të Shqyrtimit të Dhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE10). Në kuadër të këtij procesi, ZRRE-ja do të azhurnojë MAR të Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPEE/KESCO) dhe do të përshtatë MAR e Gjeneratorit të Rregulluar (KEK), Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS) bazuar në vlerat e caktuara në Shqyrtimin Periodik të bërë në kuadër të SHTE7, në mënyrë që të llogariten dallimet në mes të vlerave të kostove të parashikuara dhe atyre të realizuara. ZRRE ka paraqitur vlerësimet në Raportet Konsultative të publikuara më 24 shkurt 2016 për secilin të licencuar. Raportet i janë nënshtruar konsultimit publik për periudhë dy javore, ku të gjitha palët e interesit, përfshirë edhe konsumatorët e energjisë elektrike, kanë pasur mundësi të komentojnë apo të shprehin qëndrimet e tyre në lidhje me vlerësimet e ZRRE-së.

Ky Dokument paraqet përgjigjet në komentet e bëra nga palët e interesuara duke përmbyllur fazën e konsultimit publik për SHTE10.

Ky dokument është pjesë e ndërlidhur me dokumentet e përshkruara në tabelën më poshtë.

## Dokumentet relevante

Vlerësimi fillestar i ZRRE-së të formularëve të raportimit të KEK-ut, të dorëzuara në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik	<a href="http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/albanian/Vleresimi_fillestar_KEK_shqip.pdf">http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/albanian/Vleresimi_fillestar_KEK_shqip.pdf</a>
Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së të MAR të KEK-ut në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Vleresim_i_perkoshem_KEK_Gjenerim.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Vleresim_i_perkoshem_KEK_Gjenerim.pdf</a>
Vlerësimi përfundimtar i MAR të KEK-ut në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vlersimi_perfundimtar_per_Gjenerim_22Mars2013.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vlersimi_perfundimtar_per_Gjenerim_22Mars2013.pdf</a>
Rregulla për Vendosjen e çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar	<a href="http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/Generation_Pricing_Rule.pdf">http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/Generation_Pricing_Rule.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së mbi KEK-un i lëshuar në kuadër të SHTE9	<a href="http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Gjenerimi_Raport_konsultativ_06_03_2015.pdf">http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Gjenerimi_Raport_konsultativ_06_03_2015.pdf</a>
Vlerësimi fillestar i ZRRE-së të formularëve të raportimit të KOSTT, të dorëzuara në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik	<a href="http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/english/Vleresimi_fillestar_per_KOSTT_anglisht.pdf">http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/english/Vleresimi_fillestar_per_KOSTT_anglisht.pdf</a>
Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së të MAR të KOSTT në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Provisional_Evaluation_KOSTT_eng.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Provisional_Evaluation_KOSTT_eng.pdf</a>



Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së të MAR të KOSTT në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_KOSTT_22_March_2013.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_KOSTT_22_March_2013.pdf</a>
Rregulla për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (Rregulla për Çmime të OST/OT)	<a href="http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/TSO-MO_Pricing_Rule.pdf">http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/TSO-MO_Pricing_Rule.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së mbi KOSTT i lëshuar në kuadër të SHTE9	<a href="http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/eng/KOSTT_Raport_Konsultativ_09_03_2015_eng.pdf">http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/eng/KOSTT_Raport_Konsultativ_09_03_2015_eng.pdf</a>
Vlerësimi fillestar i ZRRE-së të formularëve të raportimit të OSSH, të dorëzuara në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik	<a href="http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/english/Vleresimi_fillestar_KEK_anglisht.pdf">http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/english/Vleresimi_fillestar_KEK_anglisht.pdf</a>
Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së të MAR të OSSH në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Provisional_Evaluation_DSO_PES_eng.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Provisional_Evaluation_DSO_PES_eng.pdf</a>
Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së të MAR të OSSH në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_KOSTT_22_March_2013.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_KOSTT_22_March_2013.pdf</a>
Rregulla për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmime të OSSH)	<a href="http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/DSO_Pricing_Rule.pdf">http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/DSO_Pricing_Rule.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së mbi OSSH i lëshuar në kuadër të SHTE9	<a href="http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/OSSH_Raport_Konsultativ_09_03_2015.pdf">http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/OSSH_Raport_Konsultativ_09_03_2015.pdf</a>
Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së të MAR të KEK në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vleresimi_përfundimtar_per_Gjenerim_22Mars2013.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/Vleresimi_përfundimtar_per_Gjenerim_22Mars2013.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së mbi Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë në kuadër të SHTE8	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2014/FPEE_Kalkulimet_e_te_Hyrave_t_e_Lejuara_Maksimale_Raporti_Perfundimtar_SHTE8_final.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2014/FPEE_Kalkulimet_e_te_Hyrave_t_e_Lejuara_Maksimale_Raporti_Perfundimtar_SHTE8_final.pdf</a>
Raporti Konsultativ i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm nga ZRRE	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Raport_vleresues_shqyrtimi_i_jashtzakonshem_10_8_2014.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Raport_vleresues_shqyrtimi_i_jashtzakonshem_10_8_2014.pdf</a>
Vlerësimi final i ZRRE-së të MAR të FPEE në kuadër të SHTE7	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_DSO_PES_22_March_2013.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_DSO_PES_22_March_2013.pdf</a>
Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së)	<a href="http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/PES_Pricing_Rule.pdf">http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/PES_Pricing_Rule.pdf</a>



Aplikacioni i KOSTT-it për përshtatje të rregullt të MAR	<a href="http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikacioni_i_KOSTT_2015.pdf">http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikacioni_i_KOSTT_2015.pdf</a>
Aplikacioni i KEK-ut për përshtatje të rregullt të MAR	<a href="http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikacioni_i_KEK_ut_2015.pdf">http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikacioni_i_KEK_ut_2015.pdf</a>
Aplikacioni i KEDS-it për përshtatje të rregullt të MAR	<a href="http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikimi_i_KEDS_2015.pdf">http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikimi_i_KEDS_2015.pdf</a>
Aplikacioni i FPEE-së për Azhurnimin Vjetor të WHPC	<a href="http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikacioni_i_KEDS_Perditsimi_i_WHPC_2015.pdf">http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/Aplikacioni_i_KEDS_Perditsimi_i_WHPC_2015.pdf</a>
Raporti i ZRRE-së për Përgjigje ndaj Komenteve në SHTE9	<a href="http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/eng/Pergjigjeje_ndaj_komenteve_03_04_2015_eng.pdf">http://www.ero-ks.org/Tarifat/2015/eng/Pergjigjeje_ndaj_komenteve_03_04_2015_eng.pdf</a>
Aplikacioni i KEK-ut për përshtatje të rregullt të MAR në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Proposal_for_charges_of_the_Public_Generator.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Proposal_for_charges_of_the_Public_Generator.pdf</a>
Aplikacioni i KESCO-s për Azhurnimin Vjetor të WHPC	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Wholesale_Electricity_Price_Application_2016.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Wholesale_Electricity_Price_Application_2016.pdf</a>
Aplikacioni i KOSTT-it për përshtatje të rregullt të MAR në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/KOSTT_Proposal_for_Allowed_Revenues_2016.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/KOSTT_Proposal_for_Allowed_Revenues_2016.pdf</a>
Aplikacioni i KEDS-it për përshtatje të rregullt të MAR në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Application_for_MAR_2016_KEDS.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Application_for_MAR_2016_KEDS.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së për MAR të KEK në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_KEK_MAR_Consultation_Paper.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_KEK_MAR_Consultation_Paper.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së për WHPC në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_WHPC_Consultation_Paper.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_WHPC_Consultation_Paper.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së për MAR të OST/OT në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_TSO_MO_Consultation_Paper.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_TSO_MO_Consultation_Paper.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së për MAR të OSSH në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_DSO_Consultation_Paper.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_DSO_Consultation_Paper.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së për MAR të FPEE në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_PES_Consultation_Paper.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/ETR10_PES_Consultation_Paper.pdf</a>



Komentet e KEK-ut mbi Raportin Konsultativ i ZRRE-së për MAR të KEK në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Komentet_e_KEK_ut_ne_Raportin_Konsultativ_te_ZRre_se_2016_Final.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Komentet_e_KEK_ut_ne_Raportin_Konsultativ_te_ZRre_se_2016_Final.pdf</a>
Komentet e KOSTT-it mbi Raportin Konsultativ i ZRRE-së për MAR të OST/OT në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/KOSTT_Komente_ndaj_Raportit_Konsultativ_per_SHTe10.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/KOSTT_Komente_ndaj_Raportit_Konsultativ_per_SHTe10.pdf</a>
Komentet e KEDS-it mbi Raportin Konsultativ i ZRRE-së për MAR të OSSH në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Komentet_e_KEDS_09_03_2016_.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Komentet_e_KEDS_09_03_2016_.pdf</a>
Komentet e KESCO-s mbi Raportin Konsultativ i ZRRE-së për MAR të FPEE në SHTE10	<a href="http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Komentet_e_KESco_09_03_2016_.pdf">http://www.ero-ks.org/2016/Tarifat/Komentet_e_KESco_09_03_2016_.pdf</a>



## Pasqyrë e Kontrollit të Çmimit

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është institucion i pavarur i cili, ndër të tjera, përcakton tarifën dhe çmimet për kompani të rregulluara të cilat operojnë në tregun e rregulluar të energjisë elektrike në Kosovë. Në rast se do kishte konkurrencë efektive, ZRRE do të aplikonte çmime të rregulluara vetëm për ato segmente të energjisë të cilat konsiderohen monopole natyrore (rrjetet e transmissioinit dhe shpërndarjes). Megjithatë, pasi që konkurrenca në gjenerim dhe furnizim me energji elektrike ende nuk është zhvilluar në nivelin i cili do të prodhonte çmime konkurrenca, ZRRE i rregullon këto segmente poashtu, duke caktuar tarifa të cilat imitojnë konkurrencën, në të njëjtën kohë mbrojnë konsumatorin nga çmimet monopoliste.

Shqyrtimet e tarifave dhe çmimeve janë procese që zhvillohen nga ZRRE në mënyrë që të caktohen Të Hyrat e Lejuara Maksimale – MAR, të cilat Kompanitë e Rregulluara lejohen t'i mbledhin për mbulimin e kostove të sektorit të energjisë. MAR caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike duke analizuar hollësisht shpenzimet dhe investimet të cilat kompanitë planifikojnë t'i bëjnë përgjatë kohës së kontrollit të çmimit. Niveli i MAR-it mundëson kompanitë që t'i mbulojnë kostot e arsyeshme operative dhe të mirëmbajtjes së impianteve dhe të fitojnë kthim të arsyeshëm në kapital nëse i realizojnë investimet e aprovuara fillimisht. Gjithashtu ZRRE përcakton caqe të efikasitetit, të cilat synojnë ngritjen e efikasitetit operativ të kompanive dhe të ofrojnë stimulime apo ndëshkime në varësi të rezultateve të arritura.

Theksi i shqyrtimit të fundit periodik ka qenë në ofrimin e nxitjeve rregullative të cilat u mundësojnë kompanive që të investojnë për të zëvendësuar infrastrukturën e vjetruar të energjisë elektrike dhe që t'i përmbushin rritjet e kërkesës në të ardhmen. ZRRE gjithashtu ka ofruar nxitje të efikasitetit në mënyrë që të përmirësohet mjedisi operativ i kompanive të rregulluara. Një pasqyrë përmbledhëse e Shqyrtimit Periodik është dhënë në Tabelën 1.



**Tabela 1 Periudha Rregullative SHTE7**

	Minierat	Gjenerimi	OST	OSSH
Investimet e lejuara (2013-2017)	105.8 milion € përgjatë 4 viteve	102.5 milion € përgjatë 4 viteve	Më shumë se 120 milion € përgjatë 5 viteve	107.2 milion € përgjatë 5 viteve
Projektet kyçe	Investime në makineri të rëndë, riparimi i dy ekskavatorëve dhe ndërtimi i shiritave transportues të dyfishtë për minierën e re në Sibovcin Jug-Perëndimor	Riparimi kapital i njësive A3, B1 dhe B2, Transporti Hidraulik i Hirit për Kosovën A dhe shtresa e jashtme e re për turbinën me presion të lartë në njësinë B1	Linja 400 kV në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, përmirësimet në SCADA/EMS & Telecom; tre nënstacione 110/10(20) kV në Gjilan, Palaj dhe Prishtinë; linja e re 110 kV nga NS Peja 3 tek 110/35 kV NS Peja 1.	Përforcimi i rrjetit (zëvendësimi i linjave 10 kV dhe 0.4 kV); eliminimi i bllokadave, veçanërisht në mbingarkesat në 35 kV dhe 10 kV, Eliminimi i linjave (kabllove) që rrinin varur, që konsideroheshin si rrezik për publikun
Nxitësit e efikasitetit	Faktori vjetor i efikasitetit prej 4% i aplikuar në të gjitha kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes së Minierës përgjatë katër viteve	Faktori vjetor i efikasitetit prej 4% i aplikuar në të gjitha kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes së Divizionit të Gjenerimit përgjatë katër viteve	Faktori vjetor i efikasitetit prej 4% i aplikuar në të gjitha kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes së Gjeneratorit të Rregulluar për katër vite; Ndëshkim dhe shpërblim varësisht nëse OST arrin apo jo cakun nxitës të humbjes së energjisë elektrike të caktuar nga ZRRE;	16.5% (pikë përqindje) të zvogëlimit të humbjeve përgjatë 6 viteve – pothuajse përgjysmim i humbjeve deri në fund të periudhës rregullative. Faktori i efikasitetit prej 5% i aplikuar për dy vitet e fundit të Periudhës Rregullative.






## 1 Hyrje

ZRRE tani është në fazat përfundimtare të procesit të Përshtatjes së Rregullt SHTE10, në të cilin trajton komentet e palëve të interesuara dhe jep përgjigje për çështjet e ngritura. Një pasqyrë e procesit të përshtatjeve është dhënë në Figurën 1, më poshtë:

**Figura 1** Pasqyrë e procesit të Përshtatjes së Rregullt



Ky dokument jep përgjigje në komentet e dhëna nga të licencuarit. Dokumentet relevante mund t'i gjeni përmes tabelës 1 nga pjesa "Abstrakti" në faqen 2 të këtij dokumenti.

## 2 Struktura e këtij raporti

Ky raport është i organizuar si në vijim (në renditje kronologjike sipas së cilës janë pranuar komentet):

- Seksioni 3 paraqet përgjigje ndaj komenteve të KEK;
- Seksioni 4 paraqet përgjigje ndaj komenteve të KOSTT;
- Seksioni 5 paraqet përgjigje ndaj komenteve të KEDS;
- Seksioni 6 paraqet përgjigje ndaj komenteve të KESCO.

## 3 Përgjigjet e ZRRE ndaj komenteve të KEK-ut

### 3.1 Komentet e dhëna nga KEK-u

Çështjet të cilat KEK i ka ngritur ndaj Raportit Konsultativ janë të përshkruara më poshtë:



- 1. Kompensimi për humbje të të hyrave për shkak të shpërthimit të vitit 2014 në TC Kosova A** – KEK i referohet vendimit të ZRRE-së për të mos kompensuar KEK-un për kosto shtesë të shkaktuara si rezultat i aksidentit pasi që ZRRE-së nuk i është treguar se arsyet e shpërthimit kanë qenë jashtë kontrollit të KEK-ut. KEK-u i referohet një kërkesë të bërë me 19 shkurt 2016 në të cilën kanë kërkuar nga ZRRE-ja për një miratim të një vlerësimi të pavarur për arsyet e shpërthimit dhe të shfrytëzojnë mundësinë për të kërkuar që ZRRE-ja të përgjigjet ndaj kërkesës së KEK-ut;
- 2. Faktori i efikasitetit i aplikuar për Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes** – KEK-u përsëritë shqetësimin e vetë se faktori vjetor i efikasitetit prej 4% i caktuar nga ZRRE gjatë Shqyrtimit Periodik është e vështirë për tu arritur edhe në rrethana strikte komerciale. KEK shpreh shqetësimin që operojnë me infrastrukturë të vjetruar dhe duhet të bartin obligime sociale, duke theksuar çështjen e 120 punëtorëve që janë punësuar si rezultat i Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të KEK-ut dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- 3. Përkrahja për Komunën e Obiliqit** – KEK-u deklaron që këto kosto nuk mund të konsiderohen si investime kapitale dhe se KEK është i obliguar që të përkrahin komunitetet lokale sipas Rregullores 04/2011 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. KEK argumenton që komunitetet lokale mund të bëhen një pengesë për planet e KEK-ut për të zgjeruar operimet e tyre nëse ZRRE-ja nuk e lejon KEK-un që të mbulojë këto fonde.
- 4. Zbatimi i Marrëveshjes Kolektive** – KEK-u nuk pajtohet me propozimin e ZRRE-së që kosto shtesë që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes Kolektive të rishikohen dhe të trajtohen gjatë shqyrtimit të ardhshëm periodik. KEK pohon se ZRRE-ja duhet të jetë konsistente për të gjithë të licencuarit në aplikimin e parimit që të gjitha kostot të cilat nuk shkaktojnë një Përshtatje të Jashtëzakonshme të trajtohen gjatë Shqyrtimit Periodik.
- 5. Studimi i fizibilitetit për sigurimin e aseteve** – KEK-u nuk pajtohet me qëndrimin e ZRRE-së që të gjitha kostot që lidhen me studimin e fizibilitetit për sigurimin e aseteve të merren parasysh gjatë Shqyrtimit Periodik. KEK-u deklaron se kosto e përafërt e studimit të fizibilitetit është rreth 0.3 milion €, ndërsa kosto e polisës së sigurimit pritet të jetë rreth 2 milion € në vit.
- 6. Obligimet financiare të ngarkuara nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerare (KPMM)** - KEK-u nuk pajtohet me qëndrimin e ZRRE-së që kjo çështje të zgjidhet posa që implikimet financiare të vendimit të KPMM-së të jenë të qarta dhe posa të zgjidhet ankesa e KEK-ut ndaj KPMM-së. KEK-u insiston që sektori duhet të jetë gati për reagim në vendimin e KPMM-së nëse përgjigja ka ndikim në kostot e KEK-ut.
- 7. Korrigjimet teknike** – KEK-u propozon që ZRRE të përshtatë Zhvlerësimin e Lejuar (DEPct), Kthimin e Lejuar (RTNct) dhe Kostot e Bartshme (PSTct) në vlerat e propozuara në SHTE10, në mënyrë që të llogaritet fakti që KEK-u ka raportuar këto vlera bazuar në pagesat e kryera brenda vitit kalendarik ndërsa ZRRE ka bërë llogaritjen për vlerat e faturuara nga operatorët për KEK-un.



8. **Rreziqet e Gjeneratorit të Rregulluar** – KEK-u shpreh shqetësimet e veta lidhur me nominimet dhe përgjegjësinë për menaxhimin e kapacitetit të tepërt. KEK-u i referohet një draft Memorandumi të Mirëkuptimit të cilin ata e kanë ndarë me KESCO-n për komente dhe i cili, nëse ka pajtueshmëri, lejon kushte më të favorshme dhe të balancuara të nominimit. KEK-u deklaron që KESCO deri më tani nuk ka shprehur interes që të diskutoj apo komentoj MeM. KEK deklaron që mbledhja e plotë e MAR të KEK është thelbësore për stabilitetin e Njësive Gjeneruese.

### **3.2 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KEK-ut**

#### **Kompensimi për humbje të të hyrave për shkak të shpërthimit të vitit 2014 në TC Kosova A**

ZRRE-ja vazhdon të qëndrojë prapa parimit të krijuar gjatë Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm që çdo kosto që lidhet me shpërthimin në TC Kosova A nuk duhet të bartet nga konsumatorët e energjisë elektrike, përderisa nuk ka një raport të besueshëm nga organet kompetente ku vërteton se arsyet e shpërthimit kanë qenë jashtë kontrollit të KEK-ut. ZRRE thekson se është e rëndësishme që të identifikohen arsyet e incidentit, megjithatë thekson se çdo studim që lidhet me të, është çështje e menaxhimit të brendshëm të KEK-ut. ZRRE do të marrë parasysh çdo informatë shtesë në lidhje me këtë çështje.

#### **Faktori i efikasitetit i aplikuar për shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes**

Faktorët e efikasitetit caktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike për kohëzgjatjen e Periudhës Rregullative në mënyrë që të lejojë kompanitë e rregulluara, të bëjnë plane afatgjata dhe të identifikojnë fushat, ku përfitimet e efikasitetit mund të arrihen. Nuk mund të pritët që konsumatorët e energjisë elektrike të paguajnë çmimin e ndonjë skeme të punësimit social në sektor.

#### **Përkrahja për Komunën e Obiliqit**

ZRRE-ja pranon se konsultimet publike dhe marrëveshjet me komunitetin lokal janë komponentë kritikë për zhvillimin e çdo projekti. ZRRE inkurajon KEK-un që të identifikoj mënyrat e bashkëpunimit, në mënyrë që komuniteti lokal të mbështesë operimet teknike dhe komerciale të KEK-ut. ZRRE-ja përbahet nga komentimi i mëtutjeshëm pasi që konsideron se kjo është një çështje e menaxhimit të brendshëm të KEK-ut.

#### **Zbatimi i Marrëveshjes Kolektive**

Qëndrimi i ZRRE-së është se të licencuarit e rregulluar duhet të lejohen të mbulojnë çdo diferencë në kosto e cila rezulton nga zbatimi i detyrueshëm i ndryshimeve ligjore. Megjithatë, Rregullat për Vendosjen e Çmimeve, vendosin parimin se diferenca në kosto kompensohet gjatë Shqyrtimit Periodik përderisa kosto nuk kalon nivelin e materialitetit për të hapur një proces të Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm. ZRRE është konsistente në trajtimin e kërkesave të të licencuarve dhe aplikon parime të njejta për të gjithë të licencuarit.



## **Studimi i fizibilitetit për sigurimin e aseteve**

Qëllimi i Përshtatjes së Rregullt është që të kalohet një proces i kompensimit automatik për diferencat në mes të kostove të parashikuara dhe realizuara, të cilat të licencuarit mund të kenë pësuar arsyeshem për shkaqe jashtë kontrollit të tyre dhe të indeksojë kostot e inflacionit dhe faktorët e efikasitetit. Siç është thënë në Raportin Konsultativ, çështja e ngritur nga KEK-u në lidhje me studimin e fizibilitetit për sigurimin e aseteve, nuk bie në fushën e procesit të Përshtatjes së Rregullt. Arsyeshmëria e kostove vendoset gjatë Shqyrtimeve Periodike, siç përcaktohet në Rregullat për Vendosjen e Çmimeve, prandaj ZRRE përmbahet nga komentimi i mëtutjeshëm në këtë drejtim.

## **Obligimet financiare të ngarkuara nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerare (KPMM)**

Qëndrimi i ZRRE-së është që të licencuarit e rregulluar duhet të lejohen të mbulojnë çdo dallim në kosto që rezulton nga zbatimi i detyrueshem i ndryshimeve ligjore. Rregullat për Vendosjen e Çmimeve, aplikojnë parimin ku diferenca e koston të kompensohet gjatë Shqyrtimit Periodik përderisa vlera e koston nuk është e mjaftueshme për të shkaktuar një proces të Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm. ZRRE përmbahet nga komentimi i mëtutjeshëm, pasi që KEK-u nuk i ka dhënë ZRRE-së informata të mjaftueshme për ndikimin në kosto të vendimit të KPMM-së.

## **Korrigjimet teknike**

ZRRE-ja ka modifikuar MAR të KEK-ut, për të pasqyruar përshtatjet në MAR nga korrigjimet teknike. MAR i KEK pas përshtatjeve është 147.5 milion euro.

## **Rreziqet e Gjeneratorit të Rregulluar**

ZRRE-ja njih vështirësitë me të cilat ballafaqohet KEK-u për shkak të disa dispozitave të Marrëveshjes së Furnizimit me Shumicë. ZRRE-ja thekson se Procedura për llogaritjen e Ngarkesave të Kapacitetit supozon që KEK kthen të gjitha të hyrat bazuar në Disponueshmërinë e Gjeneratorit të Rregulluar, siç është e definuar në Rregullën për Çmimet e Gjeneratorit të Rregulluar, e cila është pjesë e legjislacionit sekondar të ZRRE-së.

## **4 Përgjigjet e ZRRE ndaj komenteve të KOSTT-it**

### **4.1 Komentet e dhëna nga KOSTT-i**

Komentet e KOSTT-it ndaj Raportit Konsultativ adresojnë çështjet e mëposhtme:

1. Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes – KOSTT-i sugjeron që vlera e lejuar nga ZRRE-ja duhet të jetë vlera e lejuar gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik prej 6.6 milion euro e indeksuar për inflacion dhe faktor të efikasitetit.
2. Faktori i Efikasitetit – KOSTT-i ka shprehur shqetësimin se faktori i efikasitetit prej 4% i aplikuar nga ZRRE-ja ka paraqitur vështirësi që nga zbatimi i tij i parë gjatë Vitit Relevant 1. KOSTT pohon se është praktikisht e pamundur të arrihet ky faktor i efikasitetit.



3. Shpenzimet e personelit – KOSTT-i deklaron se shpenzimet për personel duhet të rriten për të përmbushur kostot shtesë që rrjedhin nga Marrëveshja Kolektive dhe për të reflektuar pagesat shtesë për shkak të përvojës së punës.
4. Kostot e Shërbimeve Ndhmëse – KOSTT-i nuk pajtohet me zvogëlimin prej 0.5 milion euro në pagesë të interesit, e cila është bërë nga ZRRE-ja për fondin e shërbimeve ndihmëse të lejuar por të pa shpenzuar nga KOSTT. Arsyeimi është se këto shpenzime nuk janë bërë për shkaqe të njohura politike, të cilat kanë qenë jashtë kontrollit të KOSTT-it.

## 4.2 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KOSTT-it

### Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes

ZRRE-ja pajtohet me KOSTT-in dhe do të bëjë përshtatjet e nevojshme. Vlera e OPMCT-së është rritur për 0.3 milionë euro duke rezultuar në 6.6 milionë euro si shpenzime operative.

### Faktori i efikasitetit

Faktorët e efikasitetit caktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike për kohëzgjatjen e Periudhës Rregullative në mënyrë që të lejojë kompanitë e rregulluara të bëjnë plane afatgjata dhe të identifikojnë fushat ku përfitimet e efikasitetit mund të arrihen.

### Shpenzimet e personelit

Qëndrimi i ZRRE-së është që të licencuarit e rregulluar duhet të lejohen të mbulojnë çdo dallim në kosto që rezulton nga zbatimi i detyrueshëm i ndryshimeve ligjore. Rregullat për Vendosjen e Çmimeve aplikojnë parimin ku diferenca e koston të kompensohet gjatë Shqyrtimit Periodik përderisa madhësia e koston nuk është e mjaftueshme për të hapur një proces të Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm.

### Kostot e Shërbimeve Ndhmëse

ZRRE-ja e pranon se të hyrat e lejuara për mbulimin e koston së Shërbimeve Ndhmëse nuk janë shpenzuar për arsye që janë jashtë kontrollit të KOSTT-it. Megjithatë, përshtatja e interesit ka qenë e aplikuar në mënyrë strikte për të kompensuar konsumatorët, duke aplikuar një nga parimet bazë të rregullimit.

## 5 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KEDS-it

### 5.1 Komentet e dhëna nga KEDS-i

1. Balanca e Energjisë – KEDS insiston që Balanca e Energjisë duhet të azhurnohet për të lejuar KEDS-in që të kthej diferencën në mes të humbjeve të lejuara aktuale nga KEK-u dhe caktuar të përcaktuar nga ZRRE para privatizimit të KEDS-it. KEDS konsideron se ZRRE-ja duhet të lejojë kthimin e diferencës prej 1.8%.



2. Aplikimi i Faktorit të Efikasitetit për të gjitha shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes – KEDS nuk pajtohet me aplikimin e faktorit të efikasitetit prej 5% nga ana e ZRRE-së për të gjitha shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes dhe sugjeron që ato kosto që nuk kanë qenë pjesë e Shqyrtimit Periodik – siç janë kostot e sigurimit shëndetësor, kostot e sigurimit të aseteve dhe kostot e shthurjes – nuk duhet të jenë subjekt i faktorit të efikasitetit.
3. Qasja e ZRRE-së për kostot e përjashtuara – KEDS nuk pajtohet me qëndrimin e ZRRE-së për kostot që lidhen me shërbimet e përjashtuara. Ndonëse KEDS pajtohet me qasjen e ZRRE-së në uljen e shpenzimeve operative në përputhshmëri me të hyrat e mbuluara nga konsumatorët në lidhje me këto shërbime, KEDS konsideron se shpenzimet kapitale duhet të trajtohen në përputhje me jetëgjatësinë e aseteve të investimeve që lidhen me to.
4. Qasja e ZRRE-së për të hyrat e korrigjuara nga humbjet – KEDS nuk pajtohet me qëndrimin e ZRRE-së për të hyrat e marra nga KEDS-i për humbjet e korrigjuara. Argumentet kryesore janë që konsumatorët mund të kërkojnë këto të hyra në ZRRE apo edhe në gjykata, ku si rezultat i kësaj, energjia e faturuar është subjekt i vlerësimit të këtyre institucioneve. Së dyti, vetëm një pjesë e kësaj vlere, e cila sipas KEDS-it është rreth 20% do të mblidhet.

## 5.2 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KEDS

### Balanca e Energjisë

ZRRE-ja pranon faktin që KEK nuk ka qenë i suksesshëm në arritjen e caktuar të humbjeve para se të barten përgjegjësitë tek KEDS. ZRRE tashmë ka dhënë një përgjigje të detajuar mbi këtë çështje në SHTE8 (Raporti Konsultativ - llogaritja e MAR të OSSH-së) i publikuar me 24 qershor 2014 dhe konfirmon se qëndrimi i ZRRE-së për këtë çështje nuk ka ndryshuar.<sup>1</sup>

Llogaritja e Humbjeve të Lejuara sipas MAR të OSSH-së dhe FPEE-së ka qenë e ndarë në bazë të parimit, që dallimi në mes të humbjeve të lejuara dhe realizuara duhet të bartet nga OSSH-ja në mënyrë që të sigurohet një nxitje për uljen e humbjeve nën nivelin e caktuar nga ZRRE, në mënyrë që OSSH të përfitojë nga arritja e caktuar të humbjeve, në të kundërt mos arritja e këtij caku do të jetë barrë e OSSH-së.

### Aplikimi i Faktorit të Efikasitetit për të gjitha shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes

Rregulla për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes thotë se faktori i efikasitetit aplikohet për të gjitha shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes, prandaj në këtë rast një parim i njejtë do të aplikohet (faktorit të efikasitetit prej 5%) ndaj të gjitha shpenzimeve të trajtuara si operative dhe të mirëmbajtjes.

---

<sup>1</sup> [http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Pergjigjet\\_ndaj\\_komenteve\\_KEDS.pdf](http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Pergjigjet_ndaj_komenteve_KEDS.pdf)



## **Qasja e ZRRE-së për kostot e përjashtuara**

Sipas Parimeve Të Përcaktimit Të Ngarkesave Për Shpërndarje është e definuar se të hyrat nga kontributet e konsumatorëve do të zbriten nga të hyrat e lejuara të të licencuarit. Prandaj ZRRE do të trajtoj me parime të njejta të gjitha të hyrat e parregulluara të periudhës rregullative 5 vjeçare.

## **Qasja e ZRRE-së për të hyrat e korrigjuara nga humbjet**

ZRRE-ja thekson se të gjitha kostot që lidhen me borxhet e këqija duhet të jenë të rikthyeshme përmes Borxheve të Këqija të Lejuara (BDTA). MAR nuk do të ndryshohet si pasojë e këtij komentit.

## **6 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KESCO-s**

### **6.1 Komentet e dhëna nga KESCO**

Komentet e KESCO-s ndaj Raportit Konsultativ adresojnë çështjet e mëposhtme:

1. Balanca e Energjisë – KESCO ritheksion që KEDS-i duhet të lejohet të mbuloj dallimin në mes të humbjeve të lejuara dhe të realizuara të shkaktuara nga KEK-u para se të ndodhte privatizimi i KEDS-it. KESCO pretendon se si rezultat i paaftësisë së KEK-ut për të përmbushur caqet e humbjeve të ZRRE-së, KEDS ishte përgjegjës për zvogëlimin e humbjeve për pothuajse 5% gjatë vitit të parë, gjë e cila, sipas mendimit të tyre është joreale dhe e paarritshme. Prandaj, KESCO propozon ri-llogaritjen e Balancës së Energjisë për të pasqyruar diferencën prej 1.8%.
2. WHPC dhe Vlerat e Eksportit – Përderisa KESCO pajtohet me parimin e ZRRE-së në llogaritjen e kostove me shumicë, shpreh shqetësimin që nivelet e parashikuara të eksportit janë mbivlerësuar. KESCO konsideron se vonesat, operimet e paqëndrueshme të njësive të TC Kosova A, riparimet e pritshme të TC Kosova B dhe eksportet jashtë pikut, janë faktorë që duhet të merren parasysh në vlerësimin e eksportit. KESCO më tej deklaroi që ZRRE-ja duhet të marrë parasysh çmimin e ulët të eksporteve gjatë natës. Gjithashtu KESCO kërkon të konsiderohet një faktor i ndarjes së eksportit, si nxitje për të eksportuar energjinë e tepërt nga KEK-u.
3. Aplikimi i faktorit të efikasitetit për të gjitha shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes – KESCO konsideron se faktori i efikasitetit nuk duhet të aplikohet për të gjitha kostot të tilla si kostot e zhvlerësimit dhe se vlera Opex për KESCO duhet të azhurnohet për të lejuar vlerën prej 6.1 milion euro.
4. Llogaritja e KREV – KESCO nuk pajtohet me qasjen e ZRRE-së ndaj trajtimit të të hyrave të korrigjuara nga humbjet si të hyra shitesë për KESCO-n. Argumentet kryesore janë se konsumatorët mund të kërkojnë këto të hyra nga ZRRE-ja dhe gjykatat, ku si rezultat i kësaj, energjia e faturuar është subjekt i vlerësimit të këtyre institucioneve. Së dyti, vetëm një pjesë e kësaj vlere, e cila sipas KEDS-it është rreth 20% do të mblidhet.



## 6.2 Përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të KESCO

### Balanca e Energjisë

ZRRE-ja pranon faktin që KEK nuk ka qenë i suksesshëm në arritjen e caktuar të humbjeve para se të barten përgjegjësitë tek KEDS-i. ZRRE-ja tashmë ka dhënë një përgjigje të detajuar mbi këtë çështje në SHTE8 (Raporti Konsultativ - llogaritja e MAR të OSSH-së) i publikuar më 24 qershor 2014 dhe konfirmon se qëndrimi i ZRRE-së për këtë çështje nuk ka ndryshuar.<sup>2</sup>

Llogaritja e humbjeve të lejuara sipas MAR të OSSH-së dhe FPEE-së ka qenë e ndarë në bazë të parimit që dallimi në mes të humbjeve të lejuara dhe atyre të realizuara duhet të bartet nga OSSH-ja, në mënyrë që të sigurohet një nxitje për uljen e humbjeve në nivelin e caktuar nga ZRRE. Në këtë mënyrë OSSH do të përfitoj nga arritja e caktuar të humbjeve, në të kundërt mos arritja e këtij caku do të jetë barrë e OSSH-së.

### Kosoto e blerjes së energjisë me shumicë - WHPC dhe vlerat e eksportit

Vlera e eksporteve është përdorur si faktor balancues në qasjen nga poshtë-lartë të llogaritur nga ZRRE, që përfshinë parashikimin e gjenerimit të energjisë elektrike dhe planifikimet e mirëmbajtjes dhe remonteve. ZRRE-ja thekson rëndësinë e të qëndruarit konsistent në parimet e llogaritjes së balancës së energjisë. Dallimet në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara do të azhurnohen automatikisht përmes aplikacionit WHPC gjatë Azhurnimeve Vjetore.

Faktori i ndarjes së eksportit të KESCO-s është vendosur në 0% gjatë Shqyrtimit të Vlerave Hyrëse në SHTE7. Sipas Rregullave për Vendosjen e Çmimeve një shqyrtim i Vlerave Hyrëse mund të fillojë ose me iniciativë të Rregullatorit ose me kërkesë të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (Neni 4 i Rregullës për Çmimet e FPEE), së paku 120 ditë para fillimit të vitit të ardhshëm relevant (Shtojca 3 Paragrafi 2 i Rregullës për Çmimet e FPEE). Pasi që procesi i Përshtatjeve të Rregullta nuk është Shqyrtim i Vlerave Hyrëse, ZRRE përmbahet nga komentimi i mëtutjeshëm i vlerave të faktorit ndarës të eksportit dhe qëndrimi i ZRRE-së për këtë çështje nuk ka ndryshuar.

### Aplikimi i Faktorit të Efikasitetit për të gjitha shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes

ZRRE-ja konfirmon se asnjë faktor i efikasitetit nuk është aplikuar për kostot e zhvlerësimit të lejuar, prandaj komenti i KESCO nuk ka ndikim në përshtatje të mëtutjeshme.

### Llogaritja KREV

Në pajtim me praktikën e mëhershme, ZRRE aplikon të gjitha përshtatjet sipas vlerave të parashikuara të energjisë, ndërkaq çështjet që kanë të bëjnë me inkasimin mbulohen nga lejetimet për Borxhin e Keq (BDTA). MAR nuk ka nevojë të ndryshohet si pasojë e këtij komenti.

---

<sup>2</sup> [http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Pergjigjet\\_ndaj\\_komenteve\\_KEDS.pdf](http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Pergjigjet_ndaj_komenteve_KEDS.pdf)





## 7 Propozimet finale të ZRRE-së për MAR të SHTE10

Kjo pjesë e raportit përmbledhë propozimet e ZRRE-së për MAR për të Licencuarit e Rregulluar, si rezultat i Përshtatjeve të Rregullta për SHTE10 dhe procesit të Shqyrtimit Vjetor.

### 7.1 Propozimi i MAR të lejuar për KEK

Kategoritë e kostove të MAR-it			Propozuar për vitin 2015	Propozuar për vitin 2016
Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes(O&M)	€ mil	OPMct	20.1	19.0
Zhvlerësimi i llogaritur	€ mil	DEPct	23.4	24.1
Kthimi në ekuitet	€ mil	RETnt	9.3	9.6
Kostoja e furnizimit me lignit e lejuar	€ mil	LGSCt	81.4	86.4
Kostot e lëndëve tjera djegëse të lejuara	€ mil	OTFct	4.4	4.5
Kostot e bartura (Pass through)të lejuara	€ mil	PSTct	3.6	5.0
Te hyrat nga hiri	€ mil		-0.2	-0.3
Sigurimi shëndetësor 2016	€ mil			0.4
Sigurimi shëndetësor 2015	€ mil			-0.1
Te hyrat nga avulli	€ mil		-1.2	-0.2
Te hyrat nga mbetjet metalike	€ mil		-0.9	-0.1
Te hyrat nga kogjenerimi	€ mil			-1.0
Kostot shtese për WIND POWER	€ mil			0.04
Përshtatja e licencës	€ mil		-0.03	
Sigurimi shëndetësor 2014	€ mil		0.7	
Të hyrat maksimale të lejuara TC "AB"	€ mil	MARt	140.3	147.5



## 7.2 Kosto e blerjes së energjisë me shumicë - WHPC

Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë		SHTE <sub>9</sub> Lejuar	SHTE <sub>9</sub> Realizuar	SHTE <sub>10</sub> Propozuar
<b>Gjenerimi i brendshëm</b>				
Gjenerimi KEK	€/MWh	26.47	26.33	28.15
	€000s	140,277	136,835	147,496
HC Ujmani dhe BRE-të tjera në OST	€/MWh	27.5	27.5	41.8
	€000s	2,310	2,663	6,614
Gjenerimi i kyçur në distribucion (mesatare)	€/MWh	43.8	43.8	57.5
	€000s	2,041	1,432.277	3,695
<b>Importet</b>				
Importet e kontraktuara	GWh	508.0	684.31	661.3
	€/MWh	55.0	51.76	51.8
	€000s	27,938	35,416.74	34,226
<b>Eksportet</b>				
Eksportet e kontraktuara	GWh	638.3	552.520	1,061.5
	€/MWh	30.8	33.31	28.12
	€000s	19,661	18,406	29,849
<b>Kostot e blerjes së energjisë</b>				
Gjenerimi KEK	€000s	140,277	136,834.542	147,496
Gjenerimi tjetër i brendshëm	€000s	4,351	4,095	10,308
Importet	€000s	27,938	35,417	34,226
<b>Totali i kostove të blerjes së energjisë</b>	<b>€000s</b>	<b>172,565</b>	<b>176,347</b>	<b>192,030</b>
Eksportet	€000s	-19,661	-18,406	-29,849
Subvencionet	€000s	0	0	0
WHEC + WHCC	€000s	152,905	157,940	162,147
<b>Marzha me Pakicë</b>				
Marzha me Pakicë	%	3%	3%	3%
Kostot e Marzhës me Pakicë	€000s	4,587	4,738	4,860
<b>WHPC</b>				
WHPCat-1 - WHPCft-1	€000s	-6,944.8	0	5,186.7
It	%	10.72%	0.00%	9.14%
(WHPCat-1 - WHPCft-1)*(1+It)	€000s	-7,857.4	0.0	5,660.6
<b>WHPCf</b>	<b>€000s</b>	<b>149,634</b>	<b>162,679</b>	<b>172,672</b>
<b>Mesatarja e Kostos me Shumicë të Energjisë (WHEA)</b>	<b>€/MWh</b>	<b>28.24</b>	<b>29.23</b>	<b>34.1</b>



### 7.3 Propozimi i MAR të lejuar për KOSTT

MAR i KOSTT		ETR <sub>9</sub> propozuar	ETR <sub>9</sub> Realizuar	ETR <sub>10</sub> propozuar
<b>Parametrat e indeksimit</b>				
Faktori i efikasitetit	%	4.00%	4.00%	4.00%
Faktori profilizues		0.00	0.00	0.00
HICP	%	0.43%	0.21%	0.21%
Euribor	%	0.25%	-0.13%	-0.13%
S-faktori	%	15.00%	15.00%	15.00%
It	%	15.25%	14.87%	14.87%
<b>Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (OPMCt)</b>				
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	6.9		6.7
<b>Zhvlerësimi i Lejuar (DEPCt)</b>				
$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	7.0		7.0
<b>Kthimi i Lejuar i Kapitalit (RTNCt)</b>				
$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	3.6		3.3
<b>Shërbimet Ndihmëse</b>				
Shërbimet Ndihmëse	€m	3.9		-0.6
<b>Humbjet e Lejuara (LSSCt)</b>				
Humbjet e Lejuara				
LSSAt	%	1.8%	1.8%	1.8%
REUEt	GWh	6,162.9	6,217.8	6,331.8
WHEAt	€/MWh	28.2	29.2	34.1
LSSCat-1			3.16	
LSSCft-1		3.132		3.88
LSACt-1	€m		3.11	
LSSCt	€m	3.021		3.89
Shpërblimi për arritjen e cakut të humbjeve				
<b>KREV</b>				
	€m	1.5		2.2
<b>MAR i KOSTT</b>				
Përshtatja	€m	-0.23031	0.012	
	€m	25.7643	23.873	22.4



## Propozimi i MAR të lejuar për KEDS

MAR i OSSH		ETR <sub>9</sub> Propozuar	ETR <sub>9</sub> Realizuar	ETR <sub>10</sub> Propozuar
<b>Parametrat e indeksimit</b>				
Faktori i Efikasitetit	%	0.00%	0.00%	5%
Faktori Profilizues		0.00	0.00	0.00
HICP	%	0.43%	0.21%	0.21%
Euribor	%	0.25%	-0.13%	-0.13%
S-faktori	%	15.00%	15.00%	15.00%
It	%	15.25%	14.87%	14.87%
<b>Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (OPMCt)</b>				
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	26.2		25.1
<b>Zhvlerësimi i Lejuar (DEPCt)</b>				
$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	8.0		8.8
<b>Kthimi i Lejuar i Kapitalit (RTNCt)</b>				
$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	12.4		14.2
<b>Humbjet e Lejuara (LSSCt)</b>				
Humbjet e Lejuara				
LSSAt	%	23.1%	28.0%	20.6%
REUEt	GWh	4,232.1	4,430.0	4,027.1
WHEAt	€/MWh	28.2	29.2	34.1
LSSCat-1			28.9	
LSSCft-1		27.6		28.3
LSACt-1			35.1	
LSSCt		22.8		23.71
<b>Përshtatjet</b>				
Të hyrat e parregulluara	€m	-2.0		-5.33
<b>KREV</b>				
KREV	€m	3.1		4.1
<b>MAR</b>				
Gjithsej MAR i OSSH	€m	75.59	71.46	76.5



## 7.4 Propozimi i MAR të lejuar për FPEE

MAR i FPEE		ETR <sub>9</sub> Propozuar	ETR <sub>9</sub> Realizuar	ETR <sub>10</sub> Propozuar
<b>Parametrat e indeksimit</b>				
Faktori i Efikasitetit	%	0.00%	0.00%	5.00%
Faktori Profizues	%	0.00	0.00	0.00
HICP	%	0.43%	0.21%	0.21%
Euribor	%	0.25%	-0.13%	-0.13%
S-faktori	%	10.47%	9.27%	9.27%
It	%	10.72%	9.14%	9.14%
<b>Kostot e Lejuara me Pakicë (RETR<sub>t</sub> – Neni 10 i Rregullës për Çmimet e FPEE)</b>				
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	6.7		6.5
$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.3		0.4
Lejimi i licencës	€m	0.1	0.1	0.1
<b>Kostot e Bartshme (PSTC<sub>t</sub>)</b>				
KOSTT taksat	€m	22.7		17.8
OSSH taksat	€m	75.6		75.0
<b>Të hyrat nga Shitjet e Humbjeve tek OST dhe OSSH</b>				
Të hyrat OST (Viti relevant t)	€m	3.132		3.9
Të hyrat OST (Viti relevant t-1)		0.112		0.0
Të hyrat OSSH (Viti relevant t)	€m	27.6		28.3
Të hyrat OSSH (Viti relevant t-1)		4.9		6.1
<b>Kostot e Kapitalit Punues (WCLC<sub>t</sub>)</b>				
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$	€m	1.9		1.7
<b>Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë (WHPC)</b>				
WHPC	€m	149.6		172.7
<b>Lejimi i Borxhit të Keq (BDTA)</b>				
BDTA	%	5%		4%
BDTA	€m	13.1		9.8
<b>KREVT</b>				
PES KREVT	€m	33.7		3.7
DSO KREVT	€m	3.1		4.1
TSMO KREVT	€m	1.5		2.2
<b>Përshtatjet tjera</b>				
SHTe8 përshtatja e humbjeve të OSSH	€m	-6.1		
SHTe8 përshtatja e humbjeve të OST	€m	0.3		
<b>MAR i FPEE</b>				
MAR i FPEE	€m	256.5	253.1	244.1